



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

**RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES**

|                      |  |   |                          |
|----------------------|--|---|--------------------------|
| <i>Zenel Hisenaj</i> | <i>Data e autorizimit të ekspertit</i><br>07.06.2022 | <i>Data e dorëzimit të raportit</i><br>13.06.2022 | Nr. i lëndës:<br>184 /22 |
|----------------------|--|---|--------------------------|

**BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT**

Me datën: 03.06.2022, **DWH-KOSOVA SHPK** -, Prishtine ka parashtruar ankesë me nr: 184/22, kundër njoftimit për të kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **“Furnizim më GPS(GNSS) Paisje për Matje Gjeodozike**  
” me nr. të prokurimit: **70433736-22-4482-1-2-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL PRISHTINA SH.A.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, , lloji i kontratës: Furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: **15.000,00 €**.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

**DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE ---“ DWH-KOSOVA SHPK”**

*Faktet*

*1. Kerkohen specifika te cilat nuk kane te bejne as me performancen, as me funksionalitetin dhe as me kualitetin e produktit, per me teper kerkohen produkte, qe kane shume kohe (mbi 10 vite ne treg), duke anashkaluar arritjet e reja ne kete fushe.*

*Pra investimi behet ne vitin 2022, por arritjet e 5 viteve te fundit as qe merren parasysh. Pra produkti qe kerkohet eshte me performance me te dobet se produkti qe disponojne prej mbi 10 vjet.*

*Konkretisht:*

*1. Kerkohet sistemi operativ Windows, duke shmangur sistemet operative Android, IOS etj.*

*Ne sistemin e telefonise (si edhe jane Kontrollerat e kerkuar) sistemi Windows perben jo me shume se 1%, pra 99% perjashtohen qe ne fillim, dhe pa motiv (motivi eshte produkti asiatic i parazgjedhur).*

*AK, me sakte zyra e prokurimit, duhet te aktualizohet me vendimet e OSHP, pasi precedenti është faktor shumë i rendesishëm në fushën e drejtësisë. Ka një vendim të OSHP, në një tender të ngjashëm, i cili për zgjedhjen e sist. operativ windows, duke përjashtuar të tjerët e ka quajtur "shkelje ligjore", duke e rrezuar si për zgjedhje të vetme.*

*Por AK mendon që qendron mbi vendimet e OSHP.*

*2. Kerkohet versioni 10 i windows, i cili është versioni i fundit, pra firmat e treta që prodhojnë produkte nuk i referohen versionit të fundit, e para për efekt kohe dhe e dyta presin që versioni i fundit i sistemit operativ të stabilizohet.*

*3. Nr, kanaleve kerkohet mbi 400 duke përjashtuar të gjithë prodhuesit që ofrojnë nën 400 kanale. Motivi nuk jepet përse ky kufizim, i cili nuk ka asnjë efekt as në performancë, as në funksionalitet dhe as në kualitet, sepse në orbitën jugore ku bën pjesë Kosova nuk ka më shumë se 70 satelite, të cilët kerkojnë jo më shumë se 280 kanale.*

*Po kështu ka një vendim OSHP që nr. e kanaleve që cileson si specifikim indirekt dhe pa influencë në performancën, funksionalitetin dhe kualitetin e GPS, por Zyra juridike e AK nuk është e aktualizuar (update-uar) me vendimet e OSHP, edhe pse e ka për detyrë.*

*4. Kerkohet matje me stekën në pjerresë, por nuk jepet asnjë informacion për pjerresinë e stekës dhe për më tepër rezistohet me këmbengulje që mos të jepet asnjë lloj pjerresie.  
Përse?!*

*5. Edhe pse kerkohet që të kapen të katër sistemet satelitore (GPS, GLO, GAL, BDS) cuditerisht vecohen 6 sinjale nga të cilët një sinjal i cili nuk është akoma operativ. Përse?!*

*6. Kerkohen saktësi të paverifikueshme, dhe për më tepër të pamundura në kushtet normale të matjes, por për më tepër me një shifer të vetme dhe jo nga.....deri..... apo >.... apo <....., si edhe është fryma e tenderit.  
Përse?!*

*7. Kerkohen specifikime kontradiktore si psh Memorje Brendshme 8RAM, një kohe që GPS e sotëm masinë me memorje të jashtme (pasi vehte kërkesa e produktit është e orinetuar nga e kaluara dhe jo nga e ardhmja)?!*

*8. Kerkohen formate të rrudhosura dhe të huaja për GPS si psh DGW ose të ngjashme me to.  
Ajo që është shkelje me të dyja kembet e LPP04/L-042 është se specifikimet teknike janë konsideruar - në kundërshtim me ligjin - përjashtuese, çka bën të panevojshme vlerësimin teknik. Tenderi bazohet vetëm në cmim, pra buxheti i tenderit nuk ka qëllim të marrë investimin maksimal me buxhetin minimal, por investimin minimal me buxhetin maksimal.*

*Ky është rast për organe të ruajtjes së financave publike.*

*I kerkojmë OSHP, që të vendosë këtë tender në shtratin ligjor*

**Pretendimet ankimore të parashtruara në ankesën e deponuar në OSHP, janë të njëjta.**

## KRITERET PËR VLERËSIM

### III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

- |   |   |
|---|---|
| <p>1. Kërkesa 1. Deklarata nën betim se operatori përmbush kërkesën mbi përshtatshmërinë të ligjit të prokurimit, Ligji Nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L068 dhe ligjin Nr. 05 L-092.</p> <p>2. Kërkesa 2. Në lidhje me tatimet, një vërtetim i lëshuar nga administrata tatimore të vendit të themelimit që OE nuk është me vonesë në pagesën e tatimeve të paktën deri në çerekun e fundit të vitit (Vetem për OE që shperblehet me kontrate);</p> <p>3. Kërkesa 3. Në lidhje me përshtatshmërinë, Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë se nuk është deklaruar i papërshtatshëm nga Gjykata kompetente (Vetem për OE që shperblehet me kontrate).</p> <p>4. Kërkesa 4. Operatori Ekonomik, në rast se është klient-konsumator i Autoritetit Kontraktues, duhet të vërtetojë se nuk është në vonesë me pagesën e faturave të ujit të lëshuara nga Autoriteti Kontraktues-KRU PRISHTINA sh.a (Vetem për OE që shperblehet me kontrate).</p> | <p>1. Evidenca 1. Deklarata e nënshkruar dhe e vulosur duke përdorur formën standarde në dosjen e tenderit-aneks 2.</p> <p>2. Evidenca 2. Kopje e një vërtetimi nga Administrata Tatimore e Kosovës përmes të cilit vërtetohet se Operatori Ekonomik nuk është në vonesë me pagesën e tatimeve</p> <p>3. Evidenca 3. Një vërtetim i lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësorë në vendit të themelimit të Operatorit Ekonomik që vërteton se situata e tillë e përshtatshmërisë nuk ekziston</p> <p>4. Evidenca 4. Një certifikatë e lëshuar nga Autoriteti Kontraktues që vërteton që një situatë e tillë nuk ekziston.</p> |
|---|---|

### III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

- |  |   |
|--|---|
| <p>1. Kërkesa 1. Operatori Ekonomik (tenderuesi) duhet të jetë i regjistruar si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në vendin e themelimit të operatorit ekonomik.</p> <p>2. Kërkesa 2. Operatori Ekonomik (tenderuesi) duhet të jetë i regjistruar si parapagues për TVSH;</p> | <p>1. Evidenca 1. Kopje e regjistrimit të biznesit në regjistrin profesional, komercial dhe ose të kor</p> <p>2. Evidenca 2. Kopja e certifikatës për TVSH poratave Kopja e certifikatës numrit fiskal;</p> |
|--|---|

### III.2.4) Përshtatshmëria profesionale:

1. Kërkesa 1. Operatori Ekonomik (tenderuesi), me tenderin e tij, duhet të dorëzojë dëshmi të cilat vërtetojnë se është i autorizuar nga Prodhuesi apo Distributori i tij i Autorizuar për ofertimin, kontraktimin apo shitjen dhe servisimin e produkteve të kërkuara ofruara në këtë dosje të tenderit.

2. Kërkesa 2. Operatori Ekonomik (tenderuesi) duhet të dëshmojë se ka kryer së paku një furnizim (kontrate për furnizim) për pajisje të ngjashme gjatë 36 muajve të fundit para datës së këtij njoftimi për kontratë;

1. Evidenca 1. AutORIZIMIN nga Prodhuesi ose Distributori i Autorizuar

2. Evidenca 2. Me tenderin tuaj ju duhet të dorëzoni kopjen e një dëshmie të dhënë si në vijim  
(i) kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij liferimi ekzekutimi shërben kopja e kontratës ose references ose ndonjë certifikatë tjetër relevante të lëshuar ose të bashkë-nënshkruara nga autoriteti i tillë Autoriteti Kontraktues;  
(ii) kur furnizimi është bërë për një klient privat, për dëshmi të këtij liferimi ekzekutimi shërben kopja e kontratës ose references ose dokumenti tjetër të nënshkruar nga klienti blerësi;

### RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

### INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KËRKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

N/A

### VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

### ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

## **PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES “DWH-KOSOVA SHPK”**

### **Pretendimi numër 1:**

*1. Kerkohet sistemi operativ Windows, duke shmangur sistemet operative Android, IOS etj.*

### **Përgjigje ne pretendimin Ankimor 1.**

**Duke gene se ne treg ekzistojnë shume prodhues te ndryshëm te cilët operojnë me Sistemin Operativ Windows, konsideroi se kjo pike ankimore nuk është e qëndrueshme.**

### **Pretendimin Ankimor 2**

*2. Kerkohet versioni 10 i windows, i cili eshte versioni i fundit, pra firmat e treta qe prodhojne produkte nuk i referohen versionit te fundit, e para per efekt kohe dhe e dyta presin qe versioni i fundit i sistemit operativ te stabilizohet.*

### **Përgjigje ne pretendimin Ankimor 2.**

**Duke gene se ne mënyrë automatike çdo version me i avancuar se kërkesat e AK-se është e pranueshme ankesa konsideroi se është e paqëndrueshme pasi edhe versionet pasi Windows 10 do te duhej te ishin te pranueshme:**

### **Pretendimin Ankimor 3.**

*3. Nr, kanaleve kerkohet mbi 400 duke perjashtuar te gjithë prodhuesit qe ofrojne nen 400 kanale. Motivi nuk jepet perse ky kufizim, i cili nuk ka asnje efekt as ne performance, as ne funksionalitet dhe as ne kualitet, sepse ne orbiten jugore ku ben pjese Kosova nuk ka me shume se 70 satelite, te cilet kerkojne jo me shume se 280 kanale.*

### **Përgjigje ne pretendimin Ankimor 3.**

**Konsideroi se AK duhet te ndryshoj ketë kriter dhe te jap hapësirë konkurrimi edhe për prodhuesit te cilët ofrojnë mundësit e kanaleve edhe nen këtë vlere, kjo pasi konsideroi se ky numër përbën ndonjë efekt performance**

### **Pretendimin Ankimor 4**

*4. Kerkohet matje me steken ne pjerresi, por nuk jepet asnje informacion per pjerresine e stekes dhe per me teper rezistohet me kembengulje qe mos te jepet asnje lloj pjerresie. Perse?!*

### **Përgjigje ne pretendimin Ankimor 4.**

**Konsideroi se është e paqëndrueshme për arse se AK edhe ne pyetjet dhe sqarimet shtese ka ofruar sqarimet te gjitha mund te gjenden edhe ne broshurat e ndryshme te këtyre pajisjeve, për me shume gjeni përgjigjen edhe te AK-se**

***“Përgjigje për pyetjen 7(pjesa e dytë), 8, 9 dhe 10(pjesa e parë) meqë është e njejta temë si duket e formuluar kështu per te shtuar numrin e pyetjeve: Antena GNSS ne vetetvet ofron sakte si milimetrike duke eliminuar***

*gabimet, te gjithë prodhuesit ofrojnë saktësinë milimetrike në broshurat e tyre. Shprehja “5mm+0.5ppm” me pak ose me shumë e gjëni në çdo broshurë të prodhuesve GNSS, kjo shprehje duhet të jetë e qartë për çdo gjeodet e aq me pakë për një OE që përfaqëson një prodhues të instrumentit. 5mm është gabimi në pozicionim kësaj duhet t’i shtohet edhe gabimi në linjen baze 0.5ppm për çdo 1 km. Për 5 mm + 0.5ppm në një distancë 500m saktësia duhet të jetë 5.25 mm në një distancë prej 10 km saktësia do të jetë 1 cm. Për varesisht nga distanca e linjes baze jepet edhe saktësia. Por është gabim të thuhet se GPS nuk ofron saktësi milimetrike. Rrjetat e rendit të lartë për pozicionim bazohen në matjet milimetrike që bëhen me antenë GNSS. Mjafton të shikoni broshurat e prodhuesve të antenave GNSS, çdo antenë ofron saktësinë milimetrike, shprehja e përdorur lartë është gjuhë e broshurave dhe nuk term i shpikur. OE ankimes përfaqëson (dy linjet e para)] - [ shih TABELA 1] aty gjëni këtë shprehje me njësi ‘mm’ -e askund nuk shkruan ‘cm’.”*

#### **Pretendimin Ankimor 5**

5. *Edhe pse kerkohet që të kapen të katër sistemet satelitore (GPS, GLO, GAL, BDS) cuditerisht vecohen 6 sinjale nga të cilët një sinjal i cili nuk është akoma operativ. Perse?!*

#### **Përgjigje në pretendimin Ankimor 5.**

**Konsideroi se është e paqëndrueshme për arse se ekzistojnë disa prodhues të ndryshëm sipas broshurave të pasqyruar edhe nga vete AK ku të njëjtat produkte plotësojnë këto kritere, gjë që AK vlerëson se janë të nevojshme për Aktivitetet e tyre.**

#### **Pretendimin Ankimor 6**

6. *Kerkohen saktësi të paverifikueshme, dhe për më tepër të pamundura në kushtet normale të matjes, por për më tepër me një shifër të vetme dhe jo nga.....deri..... apo >.... apo <....., si edhe është fryma e tenderit. Perse?!*

#### **Përgjigje në pretendimin Ankimor 6.**

**Konsideroi se vlene e njëjta përgjigje sikurse në Përgjigjen ankimore 4**

#### **Pretendimin Ankimor 7**

7. *Kerkohen specifikime kontradiktore si psh Memorje Brendshme 8RAM, një kohë që GPS e sotem masin me memorje të jashtme (pasi vehte kërkesa e produktit është e orinetuar nga e kaluara dhe jo nga e ardhmja)?!*

#### **Përgjigje në pretendimin Ankimor 6.**

**Konsideroi se është e pjesërisht e bazuar për faktin se ka edhe mundësi të tjera të ofrimit të kësaj komponentë**

#### **Pretendimin Ankimor 8**

8. *Kerkohen formate të rrudhosura dhe të huaja për GPS si psh DGW ose të ngjashme me to. Ajo që është shkelje me të dyja kembet e LPP04/L-042 është se specifikimet teknike janë konsideruar - në kundërshtim me ligjin - përjashtuese, çka bën të panevojshme vlerësimin teknik. Tenderi bazohet vetëm në cmim, pra buxheti i tenderit nuk ka qëllim të marrë investimin maksimal me buxhetin minimal, por investimin minimal me buxhetin maksimal.*

## MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues/teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, njëherë Autoriteti Kontraktues të obligohet që të bejë ndryshimet në kritere bazuar në përgjigjet përkatëse duke mos vendosur kritere Diskriminuese.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – KRUP
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues - DWH-KOSOVA SHPK